



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenet 16, 61 paragrafi 1.6 dhe nenin 64 paragrafi 3 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, merr:

### V E N D I M PËR EMËRIMIN E DREJTORIT/ESHËS TË DETYRËS SË DREJTORIT TË DREJTORISË SË KULTURËS RINISË DHE SPORTIT

#### Neni 1

**znj.Vlora Jashanica**, me kualifikim Fakulteti i Kulturës Fizike - MSC i Arteve në Kulturë Fizike Sport dhe Rekreacion, nga fshati Lupç i Poshtëm, Komuna e Podujevës, emërohet;

➤ **Ushtuese e detyrës së Drejtoreshës të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit**

#### Neni 2

E përmendura punët dhe detyrat e punës në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, do t'i ushtrojë deri në emërimin e drejtorit/eshës të Drejtorisë së cekur.

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:  
Të emëruarës  
Zyrës së personelit  
QSHQ/Arkivi*

Nr. Prot. 02-101/03-002 98 77/24  
Podujevë, datë: 02.05.2024



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Mbështetur në nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-04, Udhëzimin Administrativ MAPL nr. 2008/01 për përdorimin e automjeteve zyrtare në Komuna, dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, jep:

## AUTORIZIM

Autorizohen z. Abedin Zeka, i lindur më [redacted] në Dortmund, me vendbanim në Podujevë, numri personal [redacted] nr. i letërnjoftimit ID [redacted] lëshuar në Prishtinë dhe z.Agron Fusha i lindur më [redacted] në Podujevë me nr.personal [redacted] nr i letërnjoftimi i ID [redacted] që gjatë orarit të punës dhe jashtë orarit të rregullt të punës, në territorin e Kosovës dhe jashtë shtetit të Kosovës, të vozisë automjetin zyrtar:

Marka dhe Tipi Audi B8 A4 TDI 2.7  
Numri i shasisë WAUZZZ8K4AN001774  
Ngjyra e Zezë  
Numri i targave 01-580-ZF  
Viti i prodhimit 2009

Autorizimi vlen prej datës 02.05.2023 deri më datën 13.11.2024.

Nr.prot. 02-016/01-0028879/24  
Podujevë, datë: 02.05.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 dhe nenin 61 par 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, jep:

### AUTORIZIM

Autorizohet znj. Vlora Jashanica, Ushtruese e Detyrës së Drejtoreshës së Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit në Komunën e Podujevës të deponojë nënshkrimin në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë për vulosjen e dokumentacionit që ka të bëjë me kompetencat dhe fushë veprimtarinë e Drejtorisë së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarës \_\_\_\_\_

*I dërgohet:*

Të Autorizuarës  
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-016/01-0028881/24  
Podujevë, datë, 02.05.2024

Kryetari i Komunës  
Shpejtim Balliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

### V E N D I M

#### Neni 1

**z. Musli Kutleshi**, zyrtar i lartë për ndërtimtari në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mban autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të ndërtimit në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

#### Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së inspektorit të ndërtimit dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit/es në pozitën e cekur konform rregullativës ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ, por jo më gjatë se dy muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

#### Neni 3

I përmenduri deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarit \_\_\_\_\_

#### Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Inspeksionit, Drejtoria Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Zyra e Personelit.

#### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Me këtë vendim njoftohen:*

I Autorizuari  
Drejtoria e Inspeksionit  
Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit  
Zyra e Personelit  
QSHQ/Arkiva

Nr.prot. 02-016/01-0028783/24  
Podujevë, datë: 02.05.2024

Kryetari i Komunës  
Shpetim Bulliq





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

### V E N D I M

#### Neni 1

znj. Florie Mani, inxhinierë në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mban autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të ndërtimit në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

#### Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së inspektorit të ndërtimit dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit/es në pozitën e cekur konform rregullativës ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ, por jo më gjatë se dy muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

#### Neni 3

E përmendura deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë e pritësit dhe pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarës \_\_\_\_\_

#### Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Inspeksionit, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Zyra e Personelit.

#### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

E Autorizuara  
Drejtoria e Inspeksionit  
Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit  
Zyra e Personelit  
QSHQ/Arkiva

Nr.prot. 02-016/01-0028936/24  
Podujevë, datë: 02.05.2024

Kryetari i Komunës  
Shpirtim Gulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr. prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr. prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, në kërkesë të Drejtoreshës së Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural –DBPZHR të datës 03.05.2024, merr:

### V E N D I M

#### PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

##### Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas ftesës publike nr.12-320/01-0022347/24 të datës 05.04.2024, për përkrahje në projektin përkrahje me fidanë të dredhëzës, sistem të ujitjes dhe foli Komisioni në këtë përbërje:

- |   |           |
|---|-----------|
| - <b>Vahide Veseli</b> , zyrtare për zhvillim – DBPZHR                            | kryesuese |
| - <b>Ymer Hoti</b> , udhëheqës i sektorit për bujqësi dhe zhvillim rural - DBPZHR | anëtar    |
| - <b>Blerina Fejzullau</b> , zyrtare për rini - DKRS                              | anëtar    |

##### Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr. prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

##### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*

*Anëtarëve të komisionit*

*Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.*

*QSHQ/Arkivit*

Nr. Prot. 02-020/04-0029138/24  
Podujevë, datë, 03.05.2024





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 13 dhe 17 ( f ) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 , neneve 16 dhe 19 paragrafi 1.6 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18 dhe nenit 31.2 të Rregullores për Shërbime Publike Komunale nr. 01/155-352, Kryetari i Komunës së Podujevës, nxjerrë :

### **URDHËRESË PËR MËNYRËN E PËRDORIMIT TË UJIT PËR PIJE NGA RRJETI I UJËSJELLËSIT NË SEZONIN VEROR**

#### **Neni 1**

Në territorin e Komunës së Podujevës, në sezonin veror, caktohet mënyra dhe kufizimi i përdorimit të ujit për pije nga rrjeti i ujësjellësit.

#### **Neni 2**

1. Në sezonin veror, prej datës 07.05.2024 deri më 15.10.2024 ndalohet shfrytëzimi i ujit nga rrjeti i ujësjellësit, për:

1.1. Larjen e automjeteve, rrugëve, trotuareve dhe vendeve publike

1.2. Ujitjen e kopshteve, fushave me barë, pemëve apo ndonjë fushe të agrikulturës.

1.3. Për subjektet afariste të cilat ushtrojnë veprimtarinë e larjes së automjeteve.

#### **Neni 3**

Të gjithë konsumatorët e ujit janë përgjegjës të sigurojnë se pas pikës hyrëse, të gjitha pajisjet e ujit të jenë në funksion të plotë, duke përfshirë të gjitha rubinetet dhe pajisjet hidraulike brenda objekteve dhe pronave, si dhe pajisjeve që lidhen me sistemin kryesor të furnizimit me ujë për pije.

#### Neni 4

KUR "Prishtina"-Njësia në Podujevë do të sigurojë funksionalitetin maksimal të rrjetit të ujësjellësit të ujit për pije, gjithashtu është e obliguar të përgjigjet menjëherë pa asnjë vonesë, në çdo raportim të ndonjë defekti në sistemin e rrjetit të ujësjellësit dhe të bëjë riparimin në afatin sa më të shkurtër.

#### Neni 5

Zbatimin e Urdhëresës e bëjnë Drejtoria e Inspeksionit dhe KUR "Prishtina"- Njësia në Podujevë.

#### Neni 6

1. Mosrespektimi i Nenit 2 paragrafi 1.1 konsiderohet kundërvajtje dhe ndëshkohet me gjobë mandatore në shumë prej.....**100,00 €.**
2. Mosrespektimi i Nenit 2 paragrafi 1.2 dhe 1.3 konsiderohet kundërvajtje dhe ndëshkohet me gjobë në shumë prej.....**300.00 €**
3. Nëse ndëshkimet e shqiptuara mandatore nuk përmbushen në afat prej 15 ditësh, inspeksioni do të ndër marr veprimet përkatëse ligjore.

#### Neni 7

Urdhëresa hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-016/01-0029699/24  
Podujevë, Datë: 07.05.2024







Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronjat b) dhe i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.9, të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores Komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot. 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione merr;

### VENDIM

#### PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE ME GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE

##### Neni 1

Me këtë vendim lejohet dhënia e ndihmës financiare në shumë të përgjithshme prej 17,250.00€, ndihmë për gjashtëdhjetë (60) persona me gjendje të rëndë shëndetësore dhe ekonomike -sociale sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

##### Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

##### Neni 3

Shuma e mjeteve individuale sipas listës bashkangjitur këtij vendimi nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022.

##### Neni 4

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

##### Neni 5

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

##### Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot.02-400/01-0030195/24  
Podujevë, datë 08.05.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

### V E N D I M

#### Neni 1

**z.Rrahman Cakiqi**, inspektor i pylltarisë në Drejtorinë e Inspeksionit , krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mban autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit ambientit, dhe sipas nevojës edhe të inspektorit të shërbimeve komunale në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

#### Neni 2

Autorizimi jepet duke marrë për bazë vëllimin e punëve në dy fushat e cekura më lart dhe vlen deri në një akt tjetër administrativ.

#### Neni 3

I përmenduri deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria

#### Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Inspeksionit dhe Zyra e Personelit.

#### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Me këtë vendim njoftohen:*

I Autorizuari  
Drejtoria e Inspeksionit  
Zyra e Personelit  
QSHQ/Arkiva


Nr.prot. 02-016/01-0030192/24  
Podujevë, datë: 09.05.2024

Kryetari i Komunës  
Shefqet Bllinca





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 4, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 02-400/04-0029689/24, të datës 07.05.2024, merr:

### V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

#### Neni 1

znj. [redacted] nga fshati Bradash, Komuna e Podujevës, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor si dhe gjendjes së rënduar të banimit dhe ekonomiko-sociale i jepet ndihmë financiare në shumë 1000.00€.

#### Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë bankare të së përmendurës.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.

Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF

QSHQ/Arkivit.


znj. [redacted] (njoftohet përmes DSHMS-së)

Nr.prot 02-400/01-00333 78/24  
Podujevë, datë, 22.05.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 15 paragrafi 1 të Rregullores për kushtet kryerëse dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 02-400/04-0027447/24, të datës 26.04.2024, merr:

### V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

#### Neni 1

[REDAKTUAR], studente nga Podujeva, për mbulimin e shpenzimeve për shkollim të mëtutjeshëm në drejtimin mjekësi e përgjithshme, mbështetet me mjete financiare në shumë 500.00€.

#### Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Arsimit dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurës.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:  
Drejtorive përkatëse.  
QSHQ/Arkivit.

[REDAKTUAR] (njoftohet përmes DKA-së).

Nr. prot. 02-400/01-0035381/24  
Podujevë, datë, 22.05.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, në kërkesë të Drejtoreshës së Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural –DBPZHR të datës 24.05.2024, merr:

### V E N D I M

#### PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

##### Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas ftesës publike nr.12-320/01-0026194/24 të datës 22.04.2024, për përkrahje në projektin me serra bujqësore 50m<sup>2</sup> dhe 500m<sup>2</sup> ngritet Komisioni në këtë përbërje:

- |   |           |
|---|-----------|
| - Florie Mani, Inxhinierë – DPUMM,                        | kryesuese |
| - Shefrie Gashi, zyrtare për prodhimtari bimore - DBPZHR, | anëtare   |
| -Kujtim Zhitia, zyrtar për emergjenca-DSHPMSH,            | anëtar    |

##### Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

##### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*  
*Anëtarëve të komisionit.*  
*Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.*  
*QSHQ/Arkivit.*

Nr. Prot. 02-020/04-0034088/24  
Podujevë, datë, 27.05.2024

